


Tregtia e jashtme e mallrave

Gusht 2025

Tiranë, më 19 Shtator 2025: Në Gusht 2025 eksportet e mallrave arritën vlerën 25 mld lekë, duke u rritur me 12,9 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 27,9 %, në krahasim me muajin Korrik 2025. Importet e mallrave arritën vlerën 67 mld lekë, duke u ulur me 2,7 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 19,6 %, në krahasim me muaji Korrik 2025. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 42 mld lekë, duke u ulur me 10,2 %, krahasuar me Gusht 2024 dhe me 13,5 %, në krahasim me Korrik 2025.


Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)



Në këtë tetëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 264 mld lekë, duke u rritur me 3,5 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 582 mld lekë, duke u ulur me 2,1 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 318 mld lekë, duke u ulur me 6,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Gusht 2025, në rritjen e eksporteve prej 12,9 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +18,9 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,5 pikë përqindje, etj. Negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6,7 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me -0,6 pikë përqindje, etj.

Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Gusht 2025

Eksportet, gjatë këtij tetëmujori janë rritur me 3,5 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +10,0 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,1 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6,4 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me -0,7 pikë përqindje“, etj.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Gusht 2025, në uljen e importeve prej 2,7 %, krahasuar me një vit më parë, kanë ndikuar negativisht grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi ” me -1,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale me -1,2 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,0 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +0,6 pikë përqindje.

Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Gusht 2025

Si tetëmujor, importet janë ulur me 2,1 %, krahasuar me tetëmujorin e parë 2024. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -1,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,2 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +0,6 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +0,5 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,2 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Gusht 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Gusht 2024 janë: Kosova (94,6 %), Greqia (19,0 %), Spanja (4 herë) etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (19,6 %), Gjermania (16,1 %), etj.

Gjatë këtij tetëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (75,0 %), Greqia (10,4 %) Gjermania (6,0 %) etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (10,8 %), Kina (5,8 %), dhe Maqedonia e Veriut (30,9 %).

Në muajin Gusht 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, janë: Italia (9,8 %), Turqia (18,1 %) dhe Gjermania (9,0 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kina (18,3 %), Greqia (6,1 %) dhe Kosova (9,5 %).

Gjatë këtij tetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (4,3 %), Turqia (15,0 %) dhe Gjermania (7,0 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritje më të madhe janë: Kina (21,3 %), Greqia (3,1 %) dhe Spanja (14,0 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Gusht 2025



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 48,8 %, të gjithë tregtisë. Në Gusht 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 56,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 45,9 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (18,8 %), Kina (12,9 %), Kosova (8,6 %) Turqia (7,6 %).

Shkëmbimet tregtare, për tetëmujorin e parë 2025, me vendet e BE-së zënë 55,8 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar-Gusht 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 66,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,1 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (26,0 %), Kina (9,7 %), Greqia (7,6 %) dhe Turqia (7,2 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Gusht 2025

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2024		373	-15,4	894	2,5	-522	41,7
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	08 - 23	27	-21,9	68	-15,0	-40	40,6
	09 - 23	34	-12,8	73	-16,6	-40	45,8
	10 - 23	37	-4,3	78	-6,3	-42	46,8
	11 - 23	33	-21,8	72	-7,4	-39	46,0
	12 - 23	38	-6,6	73	-23,1	-35	51,7
	Jan-Dhj 23	440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5
	02 - 24	32	-16,1	74	6,4	-42	43,5
	03 - 24	33	-21,0	75	-7,0	-42	44,4
	04 - 24	35	1,8	75	0,6	-41	45,9
	05 - 24	35	-12,4	79	-1,6	-45	43,8
	06 - 24	35	-8,9	77	2,1	-42	45,3
	07 - 24	33	-12,0	85	21,1	-52	39,0
	08 - 24	22	-18,2	69	1,9	-46	32,6
	09 - 24	31	-8,5	71	-3,1	-40	43,3
	10 - 24	31	-15,2	77	-1,5	-46	40,3
	11 - 24	30	-8,5	73	2,0	-43	41,2
	12 - 24	26	-31,7	79	8,3	-53	32,6
	Jan-Dhj 24	373	-15,4	894	2,5	-522	41,7
2025	01 - 25	31	4,9	60	0,1	-29	51,8
	02 - 25	34	4,3	68	-8,6	-34	49,7
	03 - 25	35	4,9	74	-1,4	-39	47,3
	04 - 25	33	-4,1	76	0,4	-43	43,8
	05 - 25	35	1,2	78	-2,1	-42	45,3
	06 - 25	35	1,9	77	-0,2	-41	46,2
	07 - 25	35	5,7	83	-2,4	-48	42,2
	08 - 25	25	12,9	67	-2,7	-42	37,8
	Jan-Gusht 25	264	3,5	582	-2,1	-318	45,4

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Gusht 2025

	Eksporte				Importe			
	Gusht 2024	Gusht 2025	Jan.-Gusht 2024	Jan.-Gusht 2025	Gusht 2024	Gusht 2025	Jan.-Gusht 2024	Jan.-Gusht 2025
Vendet e BE-së	14,809	14,340	181,098	174,796	32,819	30,808	305,705	297,505
Austri	95	177	1,647	1,157	681	618	5,259	4,766
Gjermani	1,686	1,414	14,738	15,626	4,658	4,241	42,272	39,326
Greqi	1,361	1,619	15,912	17,568	4,751	5,041	45,243	46,668
Itali	8,545	6,871	111,456	99,442	11,684	10,536	125,893	120,492
Spanjë	263	1,386	7,911	11,547	1,046	1,121	9,055	10,325
Kroaci	158	188	2,914	2,001	571	622	3,294	4,921
Të tjera të BE-së	2,702	2,684	26,521	27,455	9,429	8,628	74,689	71,006
Mbretëri e Bashkuar	71	79	1,009	783	578	714	6,554	6,058
Kinë	1,189	1,257	7,352	6,929	9,025	10,678	61,574	74,702
Kosovë	3,091	6,016	26,892	47,070	1,780	1,950	10,694	9,441
Maqedonia e Veriut	831	510	9,219	6,372	910	1,467	8,009	9,294
Rusi	2	5	7	11	278	504	2,450	2,497
SHBA	214	232	2,980	2,694	1,332	1,376	12,955	12,228
Turqi	270	1,198	2,748	3,983	7,104	5,822	66,681	56,690
Ukrainë	48	12	2,501	377	235	260	2,930	2,398
Zvicër	127	70	1,690	900	903	512	5,454	6,032
Të tjera	1,841	1,669	19,585	20,050	13,956	12,998	111,619	105,079
Gjithsej	22,493	25,388	255,083	263,964	68,920	67,089	594,625	581,924

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Gusht 2025

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Gusht 2024	Gusht 2025	Jan.-Gusht 2024	Jan.-Gusht 2025	Gusht 2024	Gusht 2025	Jan.-Gusht 2024	Jan.-Gusht 2025
Gjithsej	22,493	25,388	255,083	263,964	68,920	67,089	594,625	581,924
Ushqime. pije. duhan	2,979	3,240	35,059	37,936	14,212	14,645	104,384	107,698
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	5,961	10,208	50,200	75,753	9,571	10,266	60,761	63,933
Produkte kimike dhe plastike	1,064	940	10,544	8,733	8,192	7,877	76,596	77,709
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	45	73	1,371	1,233	558	522	7,876	7,373
Prodhime druri dhe letre	628	548	6,599	6,571	2,176	2,301	19,996	19,653
Tekstile dhe këpucë	4,838	4,724	70,185	69,491	5,500	4,968	56,168	55,011
Materiale ndërtimi dhe metale	4,074	2,570	47,347	31,083	8,206	7,367	83,465	76,495
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	2,276	2,607	24,618	26,080	17,125	16,255	158,462	148,229
Të tjera	628	478	9,161	7,086	3,379	2,889	26,917	25,823

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë),
Gusht 2025

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	111,456	99,442	26,892	47,070	15,912	17,568	14,738	15,626
Ushqim, pije duhan	9,129	7,934	4,331	4,881	2,872	3,173	1,212	1,192
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	10,258	4,753	5,695	34,735	2,410	2,921	4,271	3,613
Produkte kimike dhe plastike	3,895	2,983	2,807	2,023	647	546	32	41
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1,160	1,034	4	14	146	114	1	0
Prodhime druri dhe letre	3,478	3,461	839	765	1,036	1,010	77	80
Tekstile dhe këpucë	52,747	50,320	112	69	5,282	6,144	6,224	7,069
Materiale ndërtimi dhe metale	14,498	13,254	10,769	2,034	2,824	2,801	694	612
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	12,823	12,219	1,436	1,823	151	169	1,945	2,688
Të tjera	3,468	3,484	899	726	544	689	281	331

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë),
Gusht 2025

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	125,893	120,492	61,574	74,702	66,681	56,690	45,243	46,668
Ushqim, pije duhan	21,076	23,090	1,153	1,390	3,651	3,499	12,854	14,047
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	3,586	3,761	16	10	8,203	5,699	7,213	6,444
Produkte kimike dhe plastike	15,380	15,150	5,161	5,945	8,110	7,736	7,408	8,085
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	6,040	5,614	682	650	226	277	120	96
Prodhime druri dhe letre	4,005	4,175	1,360	1,568	3,262	3,092	2,719	2,813
Tekstile dhe këpucë	23,743	22,744	9,184	9,397	7,517	6,295	4,196	4,712
Materiale ndërtimi dhe metale	14,873	13,664	8,158	12,481	19,378	18,984	6,016	5,449
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	29,561	25,811	30,359	36,967	13,347	8,178	3,071	3,555
Të tjera	7,630	6,483	5,501	6,294	2,986	2,930	1,647	1,465

Metodologjia

Publikimi i statistikave të Tregtisë së Jashtme, është subjekt i rishikimeve metodologjike, të cilat mbështeten në të dhënat administrative nga autoritetet doganore.

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues. pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifën doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri